

Të dashur prindër të fëmijëve në edukimin e hershëm!

Sezoni veror i aktiviteteve në edukimin e hershëm në Vantaa ka përfunduar dhe po fillon sezoni i ri i aktiviteteve. Të gjitha kopshtet e fëmijëve, kopshtet me dyer të hapura dhe parqet e banorëve janë të hapura nga data 3.8.2020, ndërsa veprimtaria e klubeve për fëmijë fillon më datën 13.8.2020. Dëshirojmë të ju shprehim mirë se ardhje të ngrohtë pas pushimeve verore që të gjithë fëmijëve dhe familjeve brenda të gjitha shërbimeve tona.

Ligji për edukimin e hershëm si dhe ligji i miratuar për përkujdesje private dhe në shtëpi ndaj fëmijëve, do të ndryshohen nga data 1.8.2020. Ndryshimi në ligjin për edukimin e hershëm nënkupton atë, se të gjithë fëmijët kanë të drejtën subjektive në edukimin e hershëm me orar të plotë. Përtrirja e këtij ligji në Vantaa nuk pasohet me ndryshime nga situata aktuale, pasi që në Vantaa të gjithë fëmijët kanë pasur të drejtën e orarit të plotë në edukimin e hershëm edhe përpara këtij ndryshimi të ligjit.

Gjatë kohës së pranverës me korona një pjesë e fëmijëve ishin jashtë procesit të edukimit të hershëm dhe të mësimin parashkollor për një kohë të gjatë, me ç'rast ka arsye për kujdesë të shtuar për kthimin e fëmijës në edukimin e hershëm. Mund të jetë që prindërit kanë nevojë për bisedë rreth situatës së fëmijës, dhe me këtë rast duhet rezervuar kohë shtesë për bisedë me personelin e edukimit të hershëm.

Fillimi dhe rregullat e njoftimit për fëmijët fillestar në edukimin e hershëm/mësimin parashkollor

Për shkak të situatës emergjente gjatë pranverës/verës organizimi i vizitave për fëmijët fillestar për t'u njoftuar me vendin e ri në edukimin e hershëm, kanë mbetur plotësishtë pa u realizuar. Në Vantaa ka qenë në përdorim modeli praktik për fillimin e fëmijës në edukimin e hershëm, i cili do të përshtatet me të filluar sezoni i ri i punës duke i respektuar rregullat për mbajtjen e higjienës.

Gjatë sezonit vjeshtor njoftimi në edukimin e hershëm/mësimin parashkollor mundet të realizohet mundësishtë në pjesën më të madhe në hapësirat jashtë objektit. Përveç kësaj, njoftimi do të mund të realizohet sipas mundësive nëpërmjet lidhjes mes prindërve dhe personelit duke i përdorur edhe mundësitë teknologjike nga distanca. Gjatë fazës së njoftimit, prindi së bashku me fëmijën mundet të njoftohen me hapësirat e objektit, me punën e grupeve të fëmijëve, me personelin dhe me fëmijët tjerë. Prindërit do të përkrahen të vijnë e të luajnë me fëmijët e tyre në oborrin e kopshtit poashtu me të përfunduar orari i aktivitetit ditor.

Gjatë sezonit vjeshtor prindërit dhe fëmijët do të mundën të vijnë të njoftohen me hapësirat e brendëshme të edukimit të hershëm në Vantaa nën mbikqyrjen e personelit, duke respektuar udhëzimet për higjienën. Në hapësirat e brendëshme në Vantaa për mënyrën e njoftimit, si model praktik do të përdoret modeli, sipas të cilit një punëtor merr përsipër fëmijën dhe familjen e tij dhe njoftimi bëhet, ashtuqë në atë kohë brenda në atë hapësirë nuk do të ketë fëmijë dhe persona tjerë. Duhet të shmangët prekja e pajisjeve që gjenden në koridor dhe për shembull dhënja pas lojrave.

Njoftimi me kopshtin apo me përkujdesjen ditore familjare mund të bëhet vetëm duke qenë shëndosh.

Aktiviteti i grupeve të fëmijëve

Ardhja dhe kthimi i fëmijëve në secilën njësi realizohet në mënyrë të përshtashme në bashkëpunim me prindërit. Urdhëresa lidhur me atë, se prindërit fare nuk duhet të vijnë brenda në kopsht/njësi, largohet nga përdorimi. Megjithatë, gjatë ardhjes dhe kthimit të fëmijëve duhet pasur kujdes për higjienën dhe minimizimin e kontakteve.

Grupet e fëmijëve veprojnë si normalisht në grupe të vogla gjatë orarit ditor. Gjatë aktivitetit do të minimizohen rastet e kontakteve duke organizuar aktivitetin ditor mundësishtë sa më shumë në hapësirat e jashtme dhe me shëtitje në natyrë. Shëtitja në natyrë organizohet ashtuqë, të shmangët mundësia e pjesëmarrjes së fëmijëve në atë që ndodhë jashtë.

Në kuzhinë personeli bënë ndarjen e racioneve për fëmijët. Fëmijët nuk lejohen që vetë t'i marrin ushqimet e tyre apo t'i përdorin gjërat e tjerëve si dhe mjetet e ushqimit. Nëse fëmija mungon në mësimin e edukimit të hershëm apo mësimin parashkollor, ai poashtu nuk mund të merr pjesë në hapësirat e edukimit të hershëm apo mësimin parashkollor ku jepet ushqimi.

Një lojë të pastër gjumi, sipas dëshirës, mund të merret nga shtëpia e të mbahet në kopsht. Me lojën e gjumit synohet të shtohet veçanërisht për fëmijët fillestar, ndjenja e sigurisë që të lehtësohet fjetja në gjumë. Lojra tjera të fëmijëve nga shtëpia nuk lejohen të sjellen në kopsht deri në një vendim tjetër.

Sipas udhëzimeve të Institutit për shëndetësi dhe mirëqenje, fëmija duhet të qëndroj në shtëpi, nëse ai ka madje edhe simptoma të lehta të gripit. Fëmija duhet të dërgohet për testim nga koronavirusi pa e shqetësuar atë. Fëmija mund të kthehet në kopsht pasi që ai ka kaluar një ditë dhe një natë pa simptoma. Fëmija që është infektuar nga koronavirusi duhet të qëndroj jashtë edukimit të hershëm së paku shtatë ditë pas ditës së fillimit të simptomave, por nëse duhet

edhe më gjatë, kështu që ai të ketë qenë pa simptoma së paku dy ditë para se ai të kthehet në edukimin e hershëm. Për fëmijët që ju takojnë grupeve me rrezikshmëri nga infeksioni, vlerësimi shëndetësor për pjesëmarrje në edukimin e hershëm bazohet në vlerësimin që e bënë pala që e trajton fëmijën për këtë vlerësim.

Pavarësisht kritereve për higjienë efektive do të përkujdesemi për ate, që fëmija të ketë afërsin e duhur të kujdestarit, sigurin dhe komunikimin e duhur mundësishtë njëjtë sikurse edhe më parë.

Bashkëpunimi me prindërit

Bisedimet lidhur me planifikimin e edukimit të hershëm, (finlandisht, vasu) dhe bisedimet për planifikimin e mësimin për fëmijët në mësimin parashkollor pra fin. LEOPS-bisedimet, do të bëhen gjatë vjeshtës. Gjatë kohës së situatës emergjente në sezonën pranverore, u mbajtën bisedime të suksesshme me mjete të ndryshme nga distanca. Duke i përdorur këto do të mundemi të vazhdojmë me bisedime të zakonshme.

Gjatë sezonit vjeshtor në edukimin e hershëm dhe mësimin parashkollor do të organizohen takime të prindërve, për realizimin e të cilave do të ketë marrëveshje me njësinë përkatëse në edukimin e hershëm.

Për fëmijët që janë në karantinë dhe në rrethana të izolimit mundet të mbahet kontakti me vendin e tyre në edukimin e hershëm. Për mënyrën e mbajtjes së kontakteve mundet të bisedohet më detalishtë mes prindërve të fëmijëve dhe personelit në edukimin e hershëm.

Shikimi i mësuesit të njohur, poashtu shokëve dhe kopshtit për shembull përmes një videokontakti, mundet me qenë shumë i dobishëm edhe për fëmijët e vegjël. Mesazhet nga grupet e fëmijëve të edukimit të hershëm dhe të mësimin parashkollor ofrojnë ndjenjën e kontakteve shoqërore me grupin e fëmijëve dhe munden të lehtësojnë që fëmija të ketë dashamirësi ndaj shokëve, personelit të kopshtit dhe aktiviteteve në te.

Përshëndetjet e kryemjekes për sëmundje infektive Kirsi Valtonen për prindërit e fëmijëve në kopshte (qershor 2020)

Situata me koronavirusin në Vantaa është nën kontrollë dhe kryemjekja për sëmundje infektive Kirsi Valtonen i trimëron prindërit që të sjellin fëmijët e tyre në kopshte dhe në mësimin parashkollor.

Kopshtet dhe shkollat nuk kanë qenë vende të theksuara të përhapjes së infeksionit. Valtonen na bënë me dije, se kjo sëmundje është shumë më e rrallë te fëmijët se sa te të rriturit. Raste me sëmundje të vështira të shkaktuara nga koronavirusi te fëmijët janë jashtëzakonisht të rralla dhe se në Vantaa nuk ka informata për asnjë rast të tillë. Për fëmijët është me rëndësi të jashtëzakonshme që pas pranverës të dalin për të luajtur dhe mësuar nëpër kopshte.

Shikoje videon e plotë (në finlandisht) nga [këtu](#).

Më shumë informata do të merrni nga vendi i edukimit të hershëm.

Mirë se vini në edukimin e hershëm!

Përshendetje miqësore nga Sole Askola-Vehviläinen

Drejtoresha e edukimit të hershëm